

## Statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale, 2020

**Tiranë, më 29 Prill 2021:** Në këtë publikim, statistikat e krimeve japin informacion mbi veprat penale, autorë të veprave penale, persona të dëmtuar, procedimet penale, persona të pandehur dhe të dhëna mbi të burgosurit.

### Vepra penale


Në vitin 2020, janë evidentuar gjithsej 32.736 vepra penale, 7,0 % më pak, krahasuar me vitin 2019.

**Tab. 1 Vepra penale të evidentuara**

Veprat penale	2016	2017	2018	2019	2020
Vrasje me dashje	71	50	51	58	52
Vrasje të mbetura në tentativë	132	129	114	93	114
Krime me dashje kundër shëndetit	2.579	2.650	2.493	2.449	2.521
Krime seksuale	120	113	110	155	146
Vjedhje (neni 134)	4.363	4.351	4.532	4.290	3.909
Vjedhje me dhunë	138	169	108	85	88
Vjedhje me armë	15	13	22	13	14
Vjedhje duke shpërdoruar detyrën	81	118	70	76	46
Mashtrime	1.031	1.127	1.040	959	876
Fallsifikim monedhash	73	85	82	84	86
Dhuna në familje (neni 130/a)	1.488	1.412	1.374	1.341	1.505
Krime në fushën e drogës	3.248	2.070	1.907	1.989	2.086
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	5.357	5.316	5.713	5.652	5.300
Tjetër	15.112	16.714	16.852	17.966	15.993
<b>Gjithsej</b>	<b>33.808</b>	<b>34.317</b>	<b>34.468</b>	<b>35.210</b>	<b>32.736</b>

Veprat penale Dhunë në familje, Krime në fushën e drogës dhe Krime me dashje kundër shëndetit janë rritur, krahasuar me vitin e kaluar, ndërsa pjesa tjetër e veprave penale ka pësuar rënie.

**Fig. 1 Ndryshimi në përqindje i veprave penale, 2019-2020**



**Autorë të veprave penale**


Në vitin 2020, janë regjistruar 40.956 autorë për vepër penale, 4,9 % më pak, krahasuar me vitin 2019. Numri i autorëve sipas veprave penale përfshin numrin e personave të dyshuar të cilët mund të jenë të pranishëm në më shumë se një vepër penale dhe autori numërohet në të gjitha veprat ku është i dyshuar. Ndërkohë, numri i autorëve pa përsëritje në veprat penale, në vitin 2020 është 35.213 autorë, 2,4 % më pak, krahasuar me vitin 2019.

**Tab. 2 Autorë për vepër penale**


Vepra penale	2016	2017	2018	2019	2020
Vrasje me dashje	80	48	60	78	70
Vrasje të mbetura në tentativë	164	156	149	113	139
Krime me dashje kundër shëndetit	3.282	3.487	3.264	3.279	3.342
Krime seksuale	127	111	114	162	165
Vjedhje( neni 134)	3.109	2.909	3.178	2.608	3.019
Vjedhje me dhunë	123	157	115	101	94
Vjedhje me armë	354	381	23	34	35
Vjedhje duke shpërdoruar detyrën	88	130	77	104	54
Mashtrime	1.086	1.141	1.033	983	954
Fallsifikim monedhash	70	81	77	69	69
Dhuna në familje (neni 130/a)	1.586	1.507	1.459	1.438	1.604
Krime në fushën e drogës	2.489	2.482	2.357	2.703	3.202
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	5.096	5.173	5.530	5.473	5.128
Tjetër	17.020	18.288	22.213	25.900	23.081
<b>Autorë gjithsej</b>	<b>34.674</b>	<b>36.051</b>	<b>39.649</b>	<b>43.045</b>	<b>40.956</b>
<b>Autorë pa përsëritje të veprave penale</b>	<b>31.231</b>	<b>32.289</b>	<b>34.537</b>	<b>36.083</b>	<b>35.213</b>

Meshkujt përbëjnë 94,8 % të totalit të autorëve të veprave penale dhe 30,8 % e tyre janë të grup-moshës 30-44 vjeç.

**Fig. 2 Autorë gjithsej dhe autorë meshkuj për vepër penale**



**Fig. 3 Autorë për vepër penale sipas grup-moshës**



**Të dëmtuar**


Në vitin 2020, janë regjistruar 17.829 persona të dëmtuar, 5,5 % më pak, krahasuar me vitin 2019. Personat e dëmtuar për krime kundër personit përbëjnë 38,9 % të totalit të personave të dëmtuar.

**Tab. 3 Të dëmtuar për krime kundër personit**

Të dëmtuar	2016	2017	2018	2019	2020
Krime kundër jetës	1.673	1.606	1.652	1.416	1.466
Krime kundër shëndetit	3.011	3.239	2.982	2.986	3.072
Krime seksuale	121	114	105	148	132
Vepra penale kundër lirisë së personit	165	146	173	181	143
Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit	403	350	335	321	305
Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes	1.804	1.777	1.736	1.652	1.772
Të tjera kundër personit	19	25	24	40	38
<b>Të dëmtuar për krime kundër personit</b>	<b>7.196</b>	<b>7.257</b>	<b>7.007</b>	<b>6.744</b>	<b>6.928</b>
<b>Të dëmtuar gjithsej</b>	<b>19.078</b>	<b>19.062</b>	<b>19.101</b>	<b>18.858</b>	<b>17.829</b>

Në vitin 2020, në totalin e personave të dëmtuar për krime kundër personit, femrat përbëjnë 32,8 % të të dëmtuarve dhe përqindja më e madhe e tyre vihet re në krime seksuale, krime kundër moralit, dinjitetit si edhe krime kundër fëmijëve, martesës dhe familjes.

**Fig. 4 Të dëmtuar për krime kundër personit sipas gjinisë, 2020**




**Procedime penale**

Në vitin 2020, numri i procedimeve penale të regjistruara është 27.852 procedime, 9,3 % më pak, krahasuar me vitin 2019. Nga 25.295 procedime penale të përfunduara, 23,4 % e tyre janë pushuar, 37,2 % janë pezulluar dhe 39,4 % janë dërguar për gjykim në gjykatë.

**Tab. 4 Procedime penale të regjistruara**

Veprat penale	2016	2017	2018	2019	2020
Vrasje me dashje	167	120	126	137	128
Vrasje të mbetura në tentativë	51	43	52	28	35
Krime me dashje kundër shëndetit	738	862	908	903	861
Krime seksuale	109	102	113	158	136
Vjedhje (neni 134)	9.920	9.514	9.219	8.682	7.812
Vjedhja me dhunë	146	187	118	117	123
Vjedhja me armë	31	22	35	15	15
Vjedhje duke shpërdoruar detyrën	97	127	114	85	68
Mashtrime	1.401	1.060	872	745	627
Falsifikim monedhash	94	78	80	82	86
Dhuna në familje (neni 130/a)	1.355	1.310	1.209	1.140	1.251
Krime në fushën e drogës	2.795	1.764	1.524	1.548	1.793
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	3.681	3.639	4.121	4.038	3.911
Tjetër	10.698	12.634	12.898	13.017	11.017
<b>Gjithsej</b>	<b>31.283</b>	<b>31.462</b>	<b>31.389</b>	<b>30.695</b>	<b>27.852</b>

**Fig 5: Progresi i procedimeve penale të përfunduara**




**Të pandehur**

Në vitin 2020, janë regjistruar 13.409 persona të pandehur, 8,9 % më pak, krahasuar me vitin 2019. Meshkujt përbëjnë 95,1 % në totalin e personave të pandehur.

**Tab. 5 Të pandehur për vepra penale**

Veprat penale	2016	2017	2018	2019	2020
Vrasje me dashje	192	98	111	132	110
Vrasje të mbetura në tentativë	51	33	38	32	28
Krime me dashje kundër shëndetit	705	698	622	542	508
Krime seksuale	90	79	66	111	101
Vjedhje (neni 134)	1.690	1.376	1.299	1.078	979
Vjedhja me dhunë	94	87	73	70	73
Vjedhja me armë	27	17	13	18	14
Vjedhje duke shpërdoruar detyrën	88	78	68	86	42
Mashtrime	696	827	446	384	328
Fallsifikim monedhash	53	41	45	38	22
Dhuna në familje (neni 130/a)	1.281	1.194	1.198	1.038	1.081
Krime në fushën e drogës	1.693	1.819	1.183	921	1.033
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	3.186	3.034	3.596	3.152	3.213
Tjetër	7.600	6.975	7.491	7.119	5.877
<b>Gjithsej</b>	<b>17.446</b>	<b>16.356</b>	<b>16.249</b>	<b>14.721</b>	<b>13.409</b>

**Fig. 6 Persona të pandehur sipas gjinisë**




### Të burgosur

Në vitin 2020, numri i të burgosurve në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale është 4.614 të burgosur, 8,5 % më pak, krahasuar me vitin 2019.

**Tab. 6 Të burgosur sipas veprave penale**

Vepra penale	2016	2017	2018	2019	2020
Vjedhje	956	1.049	859	811	713
Vrasje	961	994	1.053	1.006	1.012
Plagosje	100	103	94	74	80
Krime seksuale	83	90	108	117	112
Krime në fushën e drogës	1.530	1.598	1.706	1.580	1.311
Organizata kriminale	22	26	52	78	71
Mashtrim	53	99	112	129	121
Shfrytëzim prostitucioni	58	90	78	67	51
Të tjera	2.183	1.369	1.254	1.183	1.143
<b>Gjithsej</b>	<b>5.946</b>	<b>5.418</b>	<b>5.316</b>	<b>5.045</b>	<b>4.614</b>

**Fig.7 Të burgosur sipas grup-moshës**



# Metodologjia

*Burimi i të dhënave:* Të dhënat janë siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Të dhënat mbi statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.

## 1. Vepra penale

Statistikat mbi veprat penale të evidentuara japin një pamje gjithëpërfshirëse të të gjithë rasteve të raportuara në polici. Ato tregojnë numrin e veprave penale që janë raportuar dhe evidentuar si vepra penale nga policia.

## 2. Autorë

Të dhënat mbi autorët bazohen në persona të dyshuar në kryerjen e një vepre penale. Totali i autorëve paraqet numrin e autorëve për vepër penale. Një autorë mund të jetë i pranishëm në më shumë se një vepër penale.

## 3. Persona të dëmtuar

Të dëmtuarit/viktimat e veprave penale i referohen personave të dëmtuar nga kryerja e një vepre penale gjatë një viti.

## 4. Procedime penale

Statistikat mbi procedimet penale paraqesin të dhëna për procedimet penale të regjistruara, pushuara, pezulluara dhe procedimet penale të dërguara për gjykim.

Procedime të regjistruara janë procedimet që kanë filluar të hetohen në vitin korrent. Procedime të pushuara janë procedimet për të cilat prokurori në përfundim të hetimeve paraprake vendos vetë ose i kërkon gjykatës pushimin e çështjes ose akuzës, kur janë rastet e parashikuara nga neni 328 i Kodit të Procedurës Penale. Procedime të pezulluara është vendimmarrja e prokurorit në rastet kur nuk njihet autori i veprës penale ose kur i pandehuri vuan nga një sëmundje e rëndë që ndalon hetimin e mëtejshëm. Statistikat mbi procedimet penale për gjykim paraqesin numrin e çështjeve të dërguara në gjykatë për gjykim të një personi të akuzuar ose që do të akuzohet për kryerjen e një vepre penale.



## 5. Të pandehur

Statistikat për të pandehurit paraqesin të dhëna për numrin e të pandehurve të rinj që u nënshtrohen procedimeve penale për gjykim gjatë vitit referues. Në sistemin e drejtësisë, në këtë fazë ata nuk janë më persona të dyshuar në kryerjen e një vepre penale, siç ishin në polici por janë persona të akuzuar. Për qëllime statistikore, në totalin e të pandehurve janë shtuar të dhëna edhe për personat nën hetim.

## 6. Të burgosur

Të dhënat për personat në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale i referohen numrit gjithsej të personave të dënuar me burg dhe të paraburgosur, në burgje, qendrat e paraburgimit, institucionet e burgosjes së të miturve si edhe spitale të burgut, deri në dhjetor të çdo viti. Të dënuar me burg i referohet personave që ndodhen në burgje, të cilët kanë marrë dënimin përfundimtar me burgim. Të paraburgosur i referohet personave që janë në qendrat e paraburgimit dhe në burgje, ndaj të cilëve është marrë masë sigurimi “arrest në burg”.

### Përkufizime

**Vrasje me dashje:** Vepër e kundraligjshme, me anë të së cilës i hiqet jeta një personi tjetër me dashje. Përshihen veprat penale si: Neni 76 Vrasje me dashje, Neni 77 Vrasje me dashje në lidhje me një krim tjetër, Neni 78 Vrasje me paramendim, Neni 78/a Vrasje për gjakmarrje, Neni 79 Vrasje në rrethana cilësuese, Neni 79/a Vrasje e funksionarëve publik, Neni 79/b Vrasja e punonjësve të policisë së shtetit, Neni 79/c Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare, Neni 81 Vrasje e foshnjës.

**Krime seksuale:** Përfshihen nenet 100-108/a të Kodit Penal.

**Vjedhje me dhunë:** Përfshihet neni 139 i Kodit Penal.

**Krime me dashje kundër shëndetit:** Përfshihen nenet 86-90 të Kodit Penal.

**Mashtrime:** Përfshihen nenet 143-149/b të Kodit Penal.

**Fallsifikim monedhash:** Përfshihet neni 183 i Kodit Penal.

**Krime në fushën e drogës:** Përfshihen veprat penale si: Neni 283 Prodhimi dhe shitja e narkotikëve, Neni 283/a Trafikimi i narkotikëve, Neni 284 Kultivimi i bimëve narkotike, Neni 284/c Prodhimi dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope.

**Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor:** Përfshihen veprat penale si: Neni 290 Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor, Neni 291 Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor në gjendje të dehur, pa dëshmi, Neni 273 Largim nga vendi i aksidentit.